



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 166, datë 29.09.2022

PËR

**MIRATIMIN E DISA SHTESAVE DHE NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN NR. 89,
DATË 27.06.2016 “PËR KRITERET DHE KËRKESAT PËR MIRATIMIN E
SHOQËRISË AUDITUESE TË SHOQËRIVE ADMINISTRUESE TË
SIPËRMARRJEVE TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE DHE SHOQËRIVE
ADMINISTRUESE TË FONDEVE TË PENSIONIT VULLNETAR”, E NDRYSHUAR**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Rregulloren nr. 89, datë 27.06.2016 “Për kriteret dhe kërkesat për miratimin e shoqërisë audituese të shoqërive administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe shoqërive administruese të fondeve të pensionit vullnetar”, e ndryshuar, sipas materialit bashkëlidhur.**
- 2. Ngarkohet Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut të Fondeve, për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Olsi ÇOKU**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin METE**

Në rregulloren nr. 89, datë 27.06.2016 “Për kriteret dhe kërkesat për miratimin e shoqërisë audituese të shoqërive administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe shoqërive administruese të fondeve të pensionit vullnetar”, e ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

1. Në nenin 3 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1) Në shkronjën “c” fund të fjalisë shtohet togfjalëshi me këtë përmbajtje:
“dhe nenit 32 të ligjit nr. 10 197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar””.

2) Pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:
“3. Në rastin e auditimit të përbashkët nga dy shoqëri audituese, kriteret e përcaktuara në pikën 1, shkronja “a” dhe “b” dhe pikën 2, shkronja “a” të këtij neni, duhet të plotësohen bashkërisht nga të dyja shoqëritë audituese, ndërkohë kriteret e tjera të këtij neni plotësohen nga secila prej shoqërive audituese.”.

2. Në nenin 4 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1) Shkronja “a”, e pikës 1 ndryshon me këtë përmbajtje:
“Vendimin e asamblesë së aksionarëve të shoqërisë administruese për emërimin e shoqërisë audituese apo emërimin e shoqërive audituese kur auditimi do të kryhet në mënyrë të përbashkët nga dy shoqëri audituese;”.

2) Shkronja “d” e pikës 1 ndryshon me këtë përmbajtje:
“d. Vërtetim nga Organizata profesionale e audituesve ligjorë/Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar, që vërteton se:

- i. shoqëria audituese ose secila prej shoqërive audituese në rastin e auditimit të përbashkët nga dy shoqëri audituese, është person juridik i licencuar për të ushtruar veprimtari audituese në Republikën e Shqipërisë; dhe
- ii. Shoqëria audituese ose të paktën njëra prej shoqërive audituese në rastin e auditimit të përbashkët nga dy shoqëri audituese ka jo më pak se 3 (tre) vite përvojë në fushën e auditimit të pasqyrave financiare të subjekteve financiare që zbatojnë standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe të raportimit financiar (SNRF-ve);”.

3) Shkronja “d/1” e pikës 1 ndryshon me këtë përmbajtje:
“d/1. Vërtetim nga Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA), që vërteton se “ortaku kryesor i auditimit” ose të punësuarit e shoqërisë audituese/shoqërive audituese në rastin e auditimit të përbashkët, me titull profesional “auditues ligjor” kanë jo më pak se 3 (tre) vite përvojë në fushën e auditimit të pasqyrave financiare të subjekteve financiare që zbatojnë standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe të raportimit financiar (SNRF-ve);”.

4) Shkronja “e” e pikës 1 ndryshon me këtë përmbajtje:

“e. Vërtetim nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike, mbi plotësimin e kritereve të përcaktuara në nenin 3, pika 1, shkronja “d” të kësaj rregulloreje nga shoqëria audituese ose secila prej shoqërive audituese në rastin e auditimit të përbashkët nga dy shoqëri audituese;”.

5) Shkronja “f” e pikës 1 ndryshon me këtë përmbajtje:

“f. Deklaratë për përmbushjen e kërkesës së parashikuar në nenin 3, pika 1, shkronja “e” dhe pika 2, shkronja “b” të kësaj rregulloreje nga shoqëria audituese ose secila prej shoqërive audituese në rastin e auditimit të përbashkët nga dy shoqëri audituese;

6) Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1 Në rastin e auditimit të përbashkët nga 2 shoqëri audituese, për dokumentat e parashikuara në shkronjat “b” dhe “c”, të pikës 1, të këtij neni, duhet të depozitohet një dokument të përbashkët. Për dokumentat e parashikuara në shkronjat “e”, “f” dhe “g” të pikës 1, të këtij neni, të dorëzohen për secilën nga shoqëritë audituese në rast auditimi të përbashkët”.

3. Në nenin 6 bëhet ndryshimi si më poshtë:

1) Pika “ii” ndryshon me këtë përmbajtje:

“ii. Shoqëria audituese ose të paktën njëra prej shoqërive audituese në rastin e auditimit të përbashkët nga dy shoqëri audituese në rastet kur është kryer një kontroll i cilësisë së punës, është vlerësuar nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike, nën notën C.”.

4. Në nenin 11 bëhet ndryshimi si më poshtë:

1) Pika “1” ndryshon me këtë përmbajtje:

“1. Shoqëria audituese miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare kryen kontrollin në të njëjtën shoqëri administruese më vete apo si pjesë e bashkimit të dy shoqërive audituese për një periudhë jo më të gjatë se katër vjet në vazhdim, në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje dhe mund të rimarrë pjesë në auditimin e shoqërisë pas mbarimit të afatit kohor prej të paktën dy vjetësh.”.